



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 31.03.2022.
2. Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e ERE-s nr.60, datë 25.02.2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.
3. Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq i Digës Qyrmaq, Hec Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5143 kWp
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit.
5. Mbi kualifikimin dhe pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “Hec Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për vitin 2020 dhe 2021.
6. Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW.
7. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 390, seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017.
8. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 377, seria T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017.
9. Mbi kërkesën e koncesionarit “Teodori” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncensionare “Teodori 2003” sh.p.k., nr. 87, seria PV09K dhënë me vendimin e bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”, tek shoqëria “Teodori” sh.p.k..

10. Mbi zgjatjen e afatit për depozitimin nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe kritereve për përzgjedhjen e tij.
11. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021.